

ROBERT SHKURTI
JETË TË PAJETUARA
ROMAN

BOTIMET TOENA

ROBERT SHKURTI

JETË TË PAJETUARA

BOTIMET TOENA

Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktor letrar: Eris Rusi

Korrektore letrare: Sonila Kryeziu

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 9789928817037

©Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësia", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

<https://toena.al>

Ky libër u kushtohet të dënuarve të ndërgjegjes.

Autori

PARATHËNIE

Mendoni pak një shoqëri si e jona, e dalë prej tridhjetë vjetësh nga regjimi komunist, ku akoma gjallojnë fantazmat e së kaluarës, ku ende të persekutuarit, të shtypurit, të vrarët e djeshëm, nuk kanë gjetur shpazim, por kanë bartur mbi vete njollën e të dobëtisë, të atij që regjimi komunist e izolonte, e shtypte, e burgoste, e vriste dhe e mbante larg gjithçkaje që kishte të bënte me një jetë normale; një shoqëri ku akoma dhe sot ka një terr absurd mbi ato që ishin fatkeqësitë njerëzore nën goditjet e regjimit komunist.

Si është e mundur të kapërcehet dhimbja që shoqëron zemrën e njeriut të përndjekur, të persekutuar, të paragjykuar padrejtësisht nën atë regjim? Kjo pyetje ka qenë dhe vijon të mbetet e pranishme mes nesh, pa marrë dot një përgjigje të qartë. Edhe pas rënies së regjimit, nga gërmadhat e së djeshmes komuniste nuk u mor asgjë përgjigje, pak u bë për të vënë në vend drejtësinë, për të mëkuar shpirtin e atyre që mbijetuan e që tanimë kërkonin të merrnin nga jeta atë që u ishte hequr me të padrejtë. Asgjë e tillë nuk

ndodhi, e në vend të gjykatave, ku duhej të merrnin ndëshkim ithtarët xhelatë të së djeshmes, vendi u mbush me gjysmënjerëz, me ish-të përndjekur, të cilëve demokracia u hoqi nga fytyra trajtat e urisë dhe të të ftohtit, por u la të shënjuar, fatkeqësisht, gjurmët e dhimbjes dhe të pafuqisë; pafuqisë për t'u bërë ballë të njëjtëve njerëz që ndërruan lëkurë dhe u bënë pjesë e sistemit të ri, që përfituan nga kaosi i viteve postdiktaturë dhe dolën të parët, duke rrëmbyer copa pushteti nga të katra anët, kurse ish-të përndjekurit mbetën secili me fatin e kthyer në dhimbje në duart e tyre: prisnin, pa mundur të bënin dot gjë, pa mundur të merrnin shpazim për burgun, për internimet, për vuajtjet familjare; prisnin, pa e ditur që ky pranim i realitetit s'bënte tjetër veçse e zgjaste më tepër kohën e dënimit dhe agoninë e tyre.

Kjo pritje është pika ku fillon përmbysja e madhe në romanin e ri "Jetë të pajetuara" të shkrimtarit Robert Shkurti. Gjithë sa më sipër, janë vetëm sfondi për të kuptuar ujërat ku noton shpirti i Gjergj Konit, protagonist i romanit, i cili jeton makthin e tij, përndjekjen nga qentë e kufirit dhe nga ushtarët e armatosur të diktaturës, në tentativën për t'u arratisur aso kohe nga Shqipëria.

Autori i jep këtij personazhi trajtat e një antiheroit. Jeta e tij është e zymtë, e tillë ka qenë gjithmonë, e fati i keq duket sikur ka qenë i lidhur pashmangshmërisht me ekzistencën e tij. Në komunizëm ëndrrat i bjerren shpejt nga konflikti me sistemin e kohës, pastaj vjen burgun, persekutimi, braktisja, vetmia. Në demokraci

jeta e tij është një muzg i gjatë, ku rrallëherë mund të shihet një spirale e vogël drite. I dalë nga një martesë e dështuar, nga e cila ka një fëmijë, tanimë e gjejmë të jetojë me gruan e dytë, por shtëpia nuk është bekuar më me lindje fëmije. Ata jetojnë bosh, në një hapësirë që e ndajnë me njëri-tjetrin.

Gjergj Koni hyn e del midis kohëve që janë antipod i njëra-tjetrës: e djeshmja, kur ishte i ri dhe mori guximin të arratisë që në vitin e dytë në gjimnaz, dhe e sotmja, kur mosha i rëndon mbi supe bashkë me brengën e padrejtësisë së pashlyer ndaj tij. Sa i bukur, por edhe sa naiv, ky gjallim mes dy kohëve është purgatori i protagonistit. Ëndrrat bëhen reale, sa mund të preken me duar, e ai e sheh veten e tij djalosh, kur guxon të sfidojë regjimin e të kërkojë të arratiset. Pastaj ato kthehen në makthe, që nuk shuhen asnjëherë dhe e lënë të bluajë brenda vetes një tjetër rebelim: ndaj atyre që edhe sot gëzojnë frytet e pushtetit, të mësuar me pushtet gjithë jetën, por që duhet të eliminohen njëherë e përgjithmonë nga kjo botë.

Kjo kornizë rrethon përqark subjektin e krejt romanit: Shqipëria ishte një vend ku frynin erëra padrejtësie, por edhe sot mbetet një vend ku këto erëra lëvizin nga një anë në tjetrën. Konflikti përshkallëzohet brenda protagonistit, sa shpërthen në një nevojë për rebelim, por që nuk është hakmarrje. Duhet që hijet e së keqes, të bartura nga e shkuara diktatoriale, të shfarosen njëherë e përgjithmonë sot, të thuret një

plan, që mund të ngjajë sa i marrëzishëm, aq edhe përfundimtar, dhe për këtë protagonistin ka nevojë për shokët e dikurshëm, për ish-bashkëvuajtësit në burgun e Qafës së Barit, ata që kishin, si puna e tij, jetë të pajetuara deri në fund. Genc Tabaku është njëri prej tyre, atij i hapet të parit Gjergji:

Kur u përmbys regjimi, ne u gëzuan. Të gjithë shqiptarët u gëzuan. Menduam se shpëtuam njëherë e mirë nga mjerimi dhe varfëria, por jo! Qenkemi gabuar, madje shumë. Më kujtohen fillimet e lëvizjes demokratike, kur sapo kisha dalë nga burgu, atëherë kur mbaheshin mitingjet e para të demokratëve dhe njerëzit kishin dëshirë të flisnin, të shpreheshin, të nxirrnin dufin e mbledhur gjatë viteve të diktaturës. Më pas mora vesh që një shkrimtar disident, që kishte qenë i dënuar si ne, kishte dashur të fliste, por nuk e kishin lejuar. I zemëruar dhe i vrarë moralisht, kishte thënë pak a shumë kështu: "Foshnja lindi, por lindi e vdekur". Me këtë thënie i ka vënë kapak çdo gjëje, Genc...

Këto fjalë janë sintezë e dramës shpirtërore të Gjergjit. Si ai, ashtu edhe mijëra të tjerë u rrekën të besojnë te një ndryshim që nuk erdhi asnjëherë në formën e duhur për shqiptarët. Vitet kaluan dhe vendi ynë krijoi mundësitë më të mira për ata që dikur kishin qenë ajka e kastës komuniste në fuqi, xhelatët e djeshëm, që sot mbretërojnë si dikur.

Teksti, në këtë pikë, ngarkohet me një lajtmotiv që përsëritet në të gjitha takimet që Gjergji zhvillon me ish-shokët e tij të burgut: Shqipëria është vendi i të zhgënjyerve, vendi i të pashpresëve, vendi i të ikurve, vendi ku padrejtësitë marrin liridalje nga zyrat e shtetit. Por kur të gjithë qëndrojnë duarkryq e presin t'u vijë radha të shtypen nga pesha e kohës dhe e padrejtësive, Gjergji është i vendosur të veprojë.

Rrëfimi, në këtë formë, përveç linjës së kohës paralele, dje dhe sot, pasurohet me botën e brendshme të personazheve të tjera, ku troket për mbështetje protagonistit:

Me këtë që po them, më vjen ndër mend ajo përrulle e pështirë kur viktima dashurohet me xhelatin e tij. Nuk ka më keq! Të biesh në dashuri me atë që të ka vrarë, të ka përdhunuar e të ka hequr të drejtën e çdo gëzimi në jetë, unë vetëm popullin shqiptar shoh! Kjo është poshtëruese!

Ky dialog mes Gjergjit dhe Gencit përmban një të vërtetë të hidhur të shoqërisë sonë: heqim dorë lehtë nga nevoja për reagim, bëjmë kompromise, kënaqemi me atë që shtrëngojmë sot në duar dhe nuk na vret dyshimi se një jetë e tillë është e paplotë, e pajetuar. Me këtë frymë, protagonistit nis kërkimin e shokëve që mund ta mbështetin planin e tij. Është një plan që mërmëritet nga buzët te veshi i shokut që dëgjon, që nuk shtjellohet me fjalë dhe lexuesit i mbetet vetëm të hamendësojë. Çfarë ka ndër mend të

bëjë protagonistin? Një revolucion? Një përmbysje të rendit në Shqipëri, që më në fund drejtësia të vihet në vend? Një akt terrorist? Një kasaphanë që s'është parë ndonjëherë?

Këto dilema e shoqërojnë leximin dhe i përngjajnë frymëmarrjes së heroit kryesor: e shqetësuar, e mbushur plot ankth, padurim, dëshirë për t'i shkuar deri në fund qëllimit.

Me një depërtim psikologjik deri në thelbin e protagonistit, autori shpalos gjatë çdo takimi me ish-të dënuar të tjerë, jetët e tyre, dënimet e tyre në komunizëm, kthesën që kanë marrë me një jetë të re sot, në demokraci. Në fillim është radha e Bardhyl Kodrës. Ish-i dënuari në monizëm, tanimë është një njeri që ka krijuar pasuri materiale, që ka kaluar edhe te partia e krahut të majtë, e ngritur mbi bërthamën e Partisë së Punës të dikurshme. Nuk ka më ideale në Shqipërinë postkomuniste. Gjithçka ka dalë në treg, shitet pa kurrfarë ngurrimi e vendi jeton kështu një tranzicion të frikshëm, që ngjan të mos marrë fund kurrë.

- Punova ca kohë në doganë dhe u kapa mirë. Nuk pikonte, por rridhte. Mbyllja njërin sy për çdo gjë. Tekefundit, ç'më duhej mua? Mua më interesonte zarfi i mbushur.

- Si munde të filloje atje? - pyeti jo pa kërshëri Gjergji, duke mos ia ndarë vështrimin fytyrës së qeshur të shokut.

- Partia, Gjergji, partia. Ajo më rregulloi.

- Vërtet?! Je anëtar partie?! - pyeti përsëri Gjergji, por këtë herë edhe më i çuditur se më parë.

Grotesku i kësaj skene e vret Gjergjin së brendshmi, ndërsa lexuesi kaplohet nga një trishtim i thellë. Gjithçka është tjetërsuar në këto kohë që jetojmë, ndërsa morali dhe bindjet e pastra kanë kohë që nuk janë më mes nesh. Të vjen në mendje mëdyshja që edhe ky model suksesi është i paplotë, që gëzimi i këtyre njerëzve, të cilët dikur kanë vuajtur e sot mund të shijojnë mirëqenien ekonomike, është i vakët, i dyshimtë, i shtirur. Jetët e tyre janë të paplota, për sa kohë kanë pranuar paktin me djallin e tani janë në krah të tij.

Si për të evokuar të njëjtën klimë me përndjekje të diktaturës, nuk mungojnë të shfaqen në skenë edhe hetuesit e sotëm. Shefi i policisë, Kadri Bashmeta, e kthen në objektiv kryesor gjurmimin e Gjergjit dhe zbulimin e objektivave të tij. Ish-i përndjekuri përndiqet sërish dhe rrota e historisë përsëritet. Kjo klimë, që trishton, i jep rrëfimit nuanca policeske, çka e bën të fortë pezullin dhe lexuesi ndjen kërshëri t'i shkojë deri në fund tekstit.

Por çdo mik ku drejtohet, çdo shok ku përplasat, kthehet në një derë të mbyllur për Gjergjin. I vetëm kundër botës, ata që i ka menduar se ishin me të njëjtin rebelim të brendshëm si ai, tanimë janë lodhur, janë zbutur, janë kthyer në ekzistenca të vorbullta, ku fryn një erë kotësie e absurdi. Këto skena e tendosin leximin e tekstit, të lënë të mendosh se, ndoshta për

shkak të Gjergjit dhe të paktëve si ai, mund të vijë një ditë kur zbrazëtia të mbushet me diçka me vlerë, që është dinjiteti i njeriut, morali dhe besimi i tij.

Ndaj jetët e pajetuara mbeten të tilla. Përkrahja që gjen Gjergji vjen nga ata që nuk e pret: nga një ish-polic i kohës së komunizmit, që kërkon të pastrojë shpirtin nga mëkatet e së djeshmes, dhe nga një vrasës me pagesë, fytyra transparente e moralit shoqëror në Shqipërinë postkomuniste. Ish-polici rrëfen para Gjergjit krimet e kohës së dikurshme, tmerret dhe torturat që nuk kishin mbarim. Është një katarsis, që vjen në formën e një simbolike, nga e cila nuk duhet të shmangen edhe fajtorët e tjerë: rrëfe, prano, merr përsipër barrën e mëkateve dhe kërko shpazim për pjesën e mbetur të jetës...

Në përfundim, mund të themi që një pjesë e mirë e shoqërisë, krijues apo njerëz të zakonshëm, kanë kërkuar që përmes rrëfimit të tyre të hedhin dritë mbi ngjarje dhe fakte që kanë pasur tragjiken në thelb, padrejtësinë, vuajtjen, përndjekjen dhe torturën shpirtërore të përjetuar nga absurdi i komunizmit. Fati i keq mund të prekte këdo, edhe njerëzit e zakonshëm, të cilët përpiqeshin të krijonin jetën e tyre, të dashuronin, të qeshnin, të qanin si individë të lirë dhe normalë. Por a mund të flitet për normalitet nëse ne i referohemi asaj kohe? Po jeta që kemi sot, sa larg të qenët një jetë normale, e plotë mund të konsiderohet?

Kjo pyetje merr një përgjigje në këtë roman. Lexuesi njihet me një rrugëtim të gjatë, në kërkim të

vënies në vend të drejtësisë, me një protagonist që ecën në një rrugë aspak të zakonit, por në një kalvar të gjatë dhimbjesh e zhgënjimesh, të cilin autori, me dinjitet dhe me moral shpirtëror, ia përcjell lexuesit. Gjergji dëgjon, por bashkë me të dëgjojmë edhe ne. Gjergji përjeton, e bashkë me të lexuesi shtrëngohet brenda vetes e dëshiron ta thyejë këtë mallkim të pazëshëm, që ka gllabëruar moralin e vendit tonë: të japin llogari ata që janë fajtorë për jetët e pajetuara, sepse vetmia e Gjergj Konit nuk është më vetëm vetmia e tij; paradokset e jetës së Gjergjit janë edhe paradokset e frymëmarrjes që na mban gjallë; jeta e pajetuar e tij është sinjal që duhet të lëvizim, të bëjmë diçka, ta jetojmë plotësisht, më në fund, ekzistencën tonë.

Dr. Eris Rusi

1.

Gjergji vraponte me sa i hanin këmbët, pa ditur se ku. Pas e ndiqnin policët me qentë, që lehnin e kuisnin me të madhe. Arriti në buzë të një honi të thellë. U tmerrua kur e pa. Po të hidhej, do të bëhej copë e thërrime. Asnjë shenjë nuk do të ngelej nga trupi i tij i brishtë.

Ndaloi e u mbush me frymë. Policët po vinin drejt tij duke gulçuar e duke klithur si të marrë, me armët ngrehur, gati për ta qëlluar. Ishin shumë. U tremb dhe u drodh si një pemë nga një tufan i tmerrshëm.

Ngriti duart lart. U ul në gjunjë e me zë përgjërues u tha policëve: “Jo, jo, mos më vrisni! Mos më vrisni! Ju lutem, mos më vrisni! Nuk kam bërë asgjë! Nuk dua të arratisem! Nuk dua të arratisem!”.

“Të kapëm, qen bir qeni! S’ke ku shkon tani!”, i tha njëri nga policët, të cilit i kishte rënë kapela. Ai i lëshoi njërin nga qentë, që iu hodh drejt e në grykë. “Oooo!”, lëshoi një piskamë nga dhimbja dhe me duar u mundua të largonte qenin, që po i shqyente gurmazin.

Befas u zgjua dhe e pa veten të ulur në mes të krevatit. Vuri duart te fyti dhe qëndroi për disa çaste

ashtu, në errësirën e dhomës. E mbloodhi veten shpejt dhe, si u zhvendos pak prapa, u mbështet pas kokës së krevatit. “Hej Zot, shyqyr që paskam qenë në ëndërr!”, mermëriti nëpër dhëmbë.

Zemra po i rrihte shpejt prej ëndrrës së tmerrshme. U mbush mirë me frymë dhe çoi dorën mbi ballë. Disa bulëza djerse i njomën pëllëmbën. I fshiu me kurrizin e dorës. Ndezi dritën e abazhurit që ishte në të majtë mbi komodinë dhe vështroi orën që varej në murin përballë. Shënonte pesë e dyzet e dy minuta.

Hodhi vështrimin djathtas dhe u ndie paksa i lehtësuar kur pa që Frida flinte. Ajo s’i kishte dëgjuar ulërimat e tij në gjumë. Dëgjoi frymëmarrjen e saj të qetë. Fiku dritën dhe u ngrit ngadalë nga krevati për të mos e zgjuar. Eci nëpër dhomë si hije, pastaj shkoi në banjë dhe u hodhi ujë syve. Sikur erdhi në vete. U pa në pasqyrë: sytë i kishte të buhavitur, qimet e mjekrës i ishin rritur e ndoshta duhej të rruhej, por nuk ia kishte ngenë. Doli nga banja dhe shkoi në kuzhinë.

Përgatiti një kafë me aparatën ekspres. Filloi të gjerbte filxhanin mendueshëm, por u ngrit përsëri për të marrë paketën e cigareve, që e kishte lënë në dhomën e ndenjjes. Ndezi një cigare dhe e thithi thellë.

Në njërin nga dollapët e kuzhinës mori shishen e rakisë. Mbushi një teke dhe e rrëkëlëu me fund. Ia ngrohu pak gjoksin e plotë. “Ç’ne kjo ëndërr?! Çfarë do të më dalë?”, pyeti veten, pa mundur t’i jepte një shpjegim.

Gjergj Koni sapo kishte mbushur të pesëdhjetat. Jetonte me të shoqen, Fridën. Ishte martuar para disa vjetësh me të. Nuk kishin fëmijë. Ishte martesë e dytë e tij. Nga martesë e parë, që e quante të dështuar për shkak edhe të moshës së tij të re, kishte një djalë, me të cilin pothuaj nuk kishte lidhje fare. Ai jetonte me të ëmën, me ish-gruan e tij.

Teksa thithte cigaren i menduar, solli ndër mend ëndrrën që sapo kishte parë. Ishte e frikshme. E ndiqnin nga pas policë të armatosur dhe qen të mëdhenj të racës gjermane “pastor”.

Ai vraponte duke gulçuar. Përpara i ishte shfaqur një hon i thellë. Kishte kthyer kokën instinktivisht dhe kishte parë t’i afroreshin policët me qentë e tyre. Dy rrugë kishte pasur: ose të hidhej e të vdiste në vend, ose të rrinte pa lëvizur e të priste që ta kapnin.

I ishte rrëqethur trupi. Kishte sjellë ndër mend ato që kishte hequr në burg, por në çast ishte ngritur i trembur. Ëndrra e kishte kthyer vite pas, në fëmijërinë e tij plot vuajtje e mundime, në fëmijërinë që askush nuk do të kishte dashur ta jetonte. Ngjarjet i kaluan nëpër mend njëra pas tjetrës, me shpejtësinë e një avioni supersonik kur fluturon në qiell të pastër.

Ndër to kishte plot episode të pashlyeshme, që kurrë nuk do t’i shqiteshin nga kujtesa. Kishin lënë gjurmë të thella si hone e nuk mund të mbusheshin me asgjë, sado të përpiqej.

Ra në mendime. U kthye pas në kohë, në vitin e tmerrshëm 1985, kur ishte nxënës në vitin e dytë në gjimnazin “Naim Frashëri” të qytetit të Durrësit.

Ishte ditë e hënë. Atë ditë, veç lëndëve të tjera, kishte edhe gjeografi. I pëlqente ajo lëndë. As vetë nuk arrinte ta kuptonte, por historia dhe gjeografia ishin dy lëndët që i pëlqenin më shumë. E tërhiqnin si magnet.

Mësuesi e ngriti në dërrasën e zezë për ta pyetur. Pas pak do të mbaronte ora e mësimit. Përpara kishte hartën e Shqipërisë. Pyetjeve për relievin shqiptar iu përgjigj mirë, pastaj mësuesi e pyeti për liqenet e Shqipërisë.

Pasi foli për liqenin e Shkodrës, nisi të fliste për liqenin e Ohrit, siç njihej ndërkombëtarisht, ose liqenin e Poradecit, siç e njihnin pjesa më e madhe e shqiptarëve.

Duke folur rreth tij dhe duke parë relievin në hartë, papritur, si një rrufe në qiell të pastër, i shkrepri një mendim i tmerrshëm, që askush nuk do të merrte guximin ta çonte nëpër mend, aq më pak ta shprehte e të vepronte: të arratisesh, të kalonte kufirin për në Jugosllavi pikërisht në vendin që ai po tregonte në hartë me shkopin që i kishte dhënë mësuesi i gjeografisë.

Atë ditë, pasi doli nga shkolla dhe shkoi në shtëpi, mendja nuk i shqitej nga ai mendim i tmerrshëm, që i ishte ngulitur në kokë si gozhdë.

Pasi hëngri drekën, u shtri në krevatin e tij, një krevat me rrjetë teli, që fundosej sa herë shtrihej mbi

të. Gjumi e kapi menjëherë dhe ëndrra e hodhi tej Shqipërisë, në vende të largëta, që ai nuk ua dinte as emrin. Pas gjumit doli nga shtëpia.

Banonte në katin e katërt të një pallati në rrugën “Aleksandër Goga”. Para pallatit ishte një fushë e vogël basketbolli, e shtruar me qymyr, ku fëmijët e lagjes kalonin kohën e lirë.

Kur zbriti poshtë, disa nga shokët e tij po luanin. Zërat e tyre vinin të zhurmshëm. Dikush i thirri për të luajtur, por ai nuk kishte as dëshirën më të vogël për një gjë të tillë. I tha “jo” me një tundje të kokës dhe u largua.

Pasi doli në rrugën kryesore, u hodh në trotuarin tjetër dhe eci drejt oborrit të shkollës 8-vjeçare, që ndodhej përballë pallatit të tij. Qëndroi para veglave gjimnastikore. Kohët e fundit kishte filluar të merrej me to. Kjo dëshirë i kishte ardhur, sepse pothuaj të gjithë moshatarët e tij merreshin me përgatitje fizike për të pasur një trup të bukur dhe sportiv.

Gjergji vinte i gjatë, i dobët, me krahë hollakë. Kishte fytyrë të pastër dhe tipare të rregullta. Sytë i kishte të mëdhenj, vetullat të trasha, buzët të plota dhe mjekrën të mprehtë. Flokët e zinj i krihte sipas modës.

Ishte djalë i zgjuar dhe i shkathët. Bënte gjëra që moshatarët e tij as që i çonin nëpër mend. Nga natyra ishte i heshtur dhe nuk parapëlqente të shoqërohej me të tjerë. Shkaqet familjare, ndoshta e kishin bërë të tillë. Prindërit e tij ishin ndarë. Ai jetonte me të atin,

ndërsa nëna ishte larguar nga shtëpia dhe jetonte me djalin tjetër.

Në oborrin e shkollës nuk kishte njeri. Bëri disa ushtrime dhe ndali. Nuk kishte pikë dëshire të vazhdonte më shumë. Mendja i rrinte vetëm tek ideja e llahtarshme e arratisjes. Solli ndër mend hartën e mësimit të gjeografisë. E kishte fiksuar mirë vendin ku mund të kalonte. Mendja vetëm aty i punonte. Qëndroi te paralelet e shkollës derisa ra muzgu dhe më pas u kthye në shtëpi. Plani i tij kishte filluar të merrte formë.

Pas dy ditësh u nis. Ishte fundi i muajit maj. Pak ditë më parë kishte pasur ditëlindjen. Sapo kishte mbushur gjashtëmbëdhjetë vjeç. Babait i tha se do të shkonte te kushërinjtë në Fier.

Dhe vërtet ashtu bëri. Ishte shumë i lidhur me ta dhe donte t'i takonte patjetër, para se të niste zbatimin e planit të tij. Sigurisht, atyre nuk u tha asnjë fjalë për aventurën që do të ndërmernte. U nda me ta me shpirt të thyer, por puna ia donte të ishte gojëkyçur.

Mori trenin dhe zbriti në qytetin e vogël të Rrogozhinës, për të hipur më pas në trenin që vinte nga Tirana për në Gurin e Kuq të Pogradecit.

Në stacion kishte shumë udhëtarë, që mbanin në duar valixhe, çanta dhe shporta me prodhime bujqësore. Po edhe treni ishte i mbushur plot me udhëtarë. Përshkoi dy vagonë duke çarë me vështirësi e më në fund gjeti një vend të lirë në njërin prej tyre.

U ul në anë të sediljes. Kishte dëshirë të qëndronte pranë dritares së hapur, por vendet i kishin zënë një

burrë dhe një grua. Përballë tij ishin ulur dy djem të rinj tek të njëzetepestat, ndërsa në krah të tij një grua në moshë.

- Si e ke emrin, or djalë? Nga të kemi? - e pyeti burri që ishte ulur pranë dritares.

Gjergji i hodhi një vështrim dyshues e pas një ngurrimi të shkurtër iu përgjigj:

- Gjergj! Nga Durrësi jam!

- Ku po shkon?

- Në Korçë! - e gënjeu.

- Ke njerëz atje? - vazhdoi burri me pyetjen e radhës.

- Po, kam gjyshen!

- Do të rrish ca ditë, apo jo?

- Nja dy-tri ditë! - u përgjigj Gjergji dhe e hodhi vështrimin nga dritarja tjetër e trenit, duke i lënë burrit të kuptonte se nuk kishte dëshirë të fliste me të.

Pas pak kaloi fatorinoja, një grua e gjatë dhe e bëshme, e cila i kërkoi biletën. Gjergji ia tregoi dhe ajo, pasi e pa disi me dyshim, e pyeti:

- Me kë je ti?

- Vetëm.

Ngaqë iu duk më i vogël se ç'ishte në të vërtetë, gruaja e pyeti:

- Sa vjeç je?

- Gjashtëmbëdhjetë.

- Ku do të shkosh?

- Në Korçë do të shkojë, në Korçë! - foli burri kureshtar.

Gjergji e vështroi një çast, por nuk foli.

- Ashtu? E po mirë, - tha fatorinoja dhe vazhdoi të kontrollonte biletat e udhëtarëve të tjerë.

Për të mos u dhënë përgjigje pyetjeve të burrit që ishte ulur pranë dritares, Gjergji mbështeti kokën në sedilje dhe mendoi të merrte një sy gjumë. Për të arritur deri në Gurin e Kuq, duheshin afro tri orë.

Gjatë ndalesave të trenit hapte sytë dhe lexonte emrin e stacionit për të ditur se ku ndodhej. Ishte në ankhth derisa të mbërrinte.

Kur treni doli nga tuneli i gjatë i Qafës së Thanës, para syve iu shfaq liqeni i Ohrit. Në krah të majtë ishte fshati Lin, aty ku kishte bërë planin e arratisjes. “Ja, këtu duhet të vij!”, tha me vete.

Trupi iu drodh nga mornicat, sikur ta kishin zënë ethet. Fshati Lin shtrihej në formë gadishulli buzë liqenit. Një fshat piktoresk, i cili që nga Qafa e Thanës dukej shumë i bukur. Lëvizti pak nga vendi dhe ia nguli sytë ujit të liqenit. Treni vraponte drejt Gurit të Kuq.

Vende-vende, në breg të liqenit, të zinte syri kallamishte të holla e të gjata në ngjyrë të gjelbër. Herë pas here shfaqej ndonjë varkë e vogël me një ose dy peshkatarë, që gjuanin peshk. Në krah të djathtë ndodhej rruga automobilistike.

Dy kamionë të mëdhenj “Skoda”, një autobus me udhëtarë i prodhimit çek, që përdoreshin në linjat ndërurbane, si dhe një autobus fizarmonikë, nga ata të prodhimit të Shkodrës, po kalonin përgjatë rrugës. Ky

i fundit pothuajse bosh, ose ashtu iu duk atij. Më tej i zuri syri kalimthi një lapidar, por vëmendjen ia hoqi burri që rrinte nga ana e dritares.

- Sa mirë do të ishte të laheshe në gjol tani! - tha ai. Pastaj shtoi: - Po ty nuk të pëlqen gjoli, se ti lahesh në det.

Gjergji e pa i habitur, pasi fjalën “gjol” nuk e kuptoi, por burri i erdhi menjëherë në ndihmë:

- Dëgjo, more djalë! Ne këtej nga anët tona “gjol” i themi liqenit. Ja, këtë quajmë gjol, - shtoi ai duke treguar me dorë nga liqeni.

Gjergji tundi kokën në shenjë pohimi. Ishte hera e parë që e dëgjonte atë fjalë dhe vërtet iu duk çudi. Gjithsesi, nuk ia vari shumë burrit, por hodhi vështrimin tutje mbi kaltërsinë e ujit të liqenit dhe dallooi ca male të larta nga ana tjetër. Ishin male të Jugosllavisë. Zemra i rrahu fort, por nuk e dha veten.

Ëndrra po i realizohej, ishte më pranë se kurrë. Mezi po priste të arrinte në stacion dhe të merrte autobusin për t’u kthyer në fshatin Lin.

Rreth orës një e gjysmë të drekës treni mbërriti në stacion. Udhëtarët nxituan të zbrisnin. Dikush mundohej të zbriste sa më parë për të kapur autobusin e linjës për në qytetin e Korçës apo të Ersekës, dikush zgjatej për të marrë valixhen, çantat dhe shportat në mbajtëset e vagonit, që ndodheshin mbi kokat e udhëtarëve.

Gjergji rrëshqiti me të shpejtë mes udhëtarëve dhe, pasi zbriti nga treni, pyeti një grua se ku nisej autobusi

për në Lin. Gruaja bëri me dorë drejt një autobusi të vjetër dhe ai shkoi drejt tij.

Autobusi nisej rreth orës dy e tridhjetë. Mendoi të hante diçka, por, për çudi, nuk kishte uri. Ndoshta ngaqë ishte tejet i tensionuar. U sorollat nëpër stacion derisa erdhi orari i nisjes së autobusit.

I bëri përshtypje radha e madhe e njerëzve, që shtyreshin për të prerë bileta për në qytetet e Juglindjes. Një pështjellim i vërtetë: fytyra të vuajtura e të djersitura, që luftonin deri në kacafytje për të arritur sa më parë te një dritare e vogël, ku duart e tyre zgjatnin të hollat për të marrë biletat e udhëtimit.

E zuri frika dhe u largua menjëherë drejt vendit ku i kishte thënë gruaja, të cilën e kishte pyetur pak më parë. Hipi në autobus dhe zuri vend pranë udhëtarëve të tjerë. Ishin katër gjithsej.

Rreth orës tre autobusi mbërriti në fshatin Lin. Sapo shoferi hapi derën, një ushtar i armatosur, me mëngët e xhaketës përveshur dhe me kopsën e sipërme zbërthyer, hipi në autobus dhe nisi t'u kërkonte udhëtarëve dokumentin e identifikimit. Në krah kishte një kallashnikov. Për ushtarin udhëtarët ishin fytyra të njohura, por gjithsesi i kontrolloi. I hodhi një vështrim shkarazi Gjergjit, pa i thënë asgjë, duke menduar se djaloshi do të ishte me ndonjërin nga udhëtarët.

Gjergji kishte veshur një palë pantallona teritali në ngjyrë të errët dhe një këmishë me mëngë të shkurtra në ngjyrë të blertë. Binte në sy si djalë qyteti nga veshja, ndryshe nga bashkëmohatarët e tij fshatarë.

Ai nuk e dinte që në zonat kufitare bëhej kontroll. Në çast ndjeu frikë se mos veshja e tradhtonte. Truri nisi t'i punonte me shpejtësi për ndonjë të papritur tjetër. Gjithsesi, i shkoi mirë. Ushtari zbriti i pari dhe më pas udhëtarët.

Pasi zbriti nga autobusi, Gjergji hodhi vështrimin përreth. Një re e vogël pluhuri, e ngritur nga ndalimi i autobusit, endej në ajër. Ndjeu pluhurin t'i hynte në hundë dhe në gojë, ndaj vuri dorën sipër tyre dhe, pa e vënë re njeri, pështyu dy-tri herë në tokë.

Një valë hutimi e pushtoi papritmas. Nuk dinte nga të shkonte. Bëri disa hapa dhe u ndodh para një dyqani, i vetmi që ndodhej në fshat. Mbi derën e dyqanit ishte një tabelë e shtrembër, e shkruar me shkrim të keq, që lexonte “Artikuj të përzier”. Dyqani ishte i vogël. Hyri brenda. Në atë gjysmerrësirë dalloj në banak shitësin, që po i shërbente një klienti. Në një cep të dyqanit i zunë sytë disa kopertona biçikletash nga ata të prodhimit të “NISH Goma” të Durrësit. Në atë kohë në Shqipëri kopertonat e biçikletave ishin me pikatore dhe ishte me fat ai që gjente të tillë nëpër dyqane.

Zakonisht fshatrave edhe mund të gjeje, pasi biçikleta nuk përdorej shumë. “Po të më pyesë kush se pse ndodhem këtu, do t'u them se kam ardhur të ble kopertona biçiklete për dajën ose xhaxhain që kam në Korçë”, tha me vete dhe ndërkohë sytë i shkuan te disa pako me llokume.

Ndjeu uri. I kërkoi shitësit t'i jepte një pako. Pagoi dhe doli. Jashtë e hapi kutinë dhe filloi të hante.

Ishin disa copa në formë katrore. Pluhuri i bardhë që mbulonte llokumet, iu ngjit në duar e buzë.

Në çast u pendua që nuk kishte ngrënë ndonjë gjë për të qenë në restorantin e stacionit të trenit në Gur të Kuq, por tashmë ishte vonë. Fajin ia vuri faktit që nuk kishte pasur uri në ato çaste. Llokumet i ranë plumb në stomak. Kishte ngrënë gati gjysmën e tyre. Llokumet që i mbetën i futi në çantë, që t'i hante në darkë, dhe po shikonte për ndonjë çezmë.

E kishte marrë etja. Llokumet e kishin ndezur edhe më shumë. Pasi shoi etjen në një nga çezmat e fshatit, u hodhi disa grushte ujë syve për t'u freskuar. Koha ishte e ngrohtë dhe nga liqeni vinte një flad i lehtë. U ndie i lehtësuar.

Ca vështrime të çuditshme nga kalimtarë të çastit, me fytyra të vrara dhe të djegura nga rrezet e diellit, e ndiqnin vazhdimisht, por nuk u dha rëndësi. “Ndoshta askujt nuk i shkon mendja te qëllimi im. Ndoshta askush nuk dyshon tek unë. Mbase fshatarët mendojnë se kam ardhur te ndonjë i afërm këtu”, tha me vete.

Ndjeu keqardhje për ta, teksa shikonte fytyrat e tyre të vuajtura dhe veshjen si mos më keq. U sorollat edhe pak dhe ndjeu se kishte nevojë të çlodhej. Eci drejt dyqanit dhe u ul mbi një grumbull trarësh të kalbur, që ishin hedhur në krah të tij. Ajo kohë pritjeje iu duk tepër e gjatë.

Sapo ra muzgu, mori të përpjetën dhe u largua nga fshati me mendimin se kishte ardhur çasti për të

kaluar kufirin. Eci gjithë frikë se mos e ndiqte dikush nga pas. Duke kthyer kokën sa majtas-djathtas, doli mbi ca kodrina të vogla përballë fshatit dhe hyri në mes të ca shkurreve.

Sheshoi vendin dhe qëndroi atje i fshehur derisa u errësua fare. Hëngri llokumet që i kishin mbetur dhe kutinë e kartonit e fshehu me kujdes poshtë shkurreve, që të mos linte ndonjë shenjë dyshimi. Kishte frikë nga ushtarët që patrullonin zonën. Tek rrinte i struktur mes shkurreve, zemra i rrihte pa pushim si e një zogu të vogël që ndien se e ndjekin.

Ndjeu të ftohtë. Era e liqenit i shkaktoi mornica nëpër trup. Dhëmbët i kërcitnin. Krahët i mbështolli rreth trupit dhe nisi të fërkohej për t'u ngrohur paksa. Për një çast ngriti sytë drejt qiellit.

Ca re të vogla, të zeza lëviznin ngadalë në drejtim të maleve nga ana tjetër e liqenit. “Duhej të kisha marrë një triko me mëngë të gjata”, tha me vete. Nuk e kishte menduar se mund të prishej koha dhe nuk e kishte llogaritur të ftohtin që mund të shkaktonte nata.

Vështrimin e mbante të ngulur në drejtim të kufirit, aty ku duhej të kalonte. Te një brez i kufirit ishte mbjellë një sipërfaqe me grurë. Gruri vinte i lartë dhe i gjelbër, pra nuk i kishte ardhur ende koha të korrej.

Era e liqenit e bënte të dallgëzohej lehtë, si një valë e butë deti. Retë vazhdonin të largoheshin ngadalë, duke bërë që qielli të pastrohej prej tyre. Hëna ndriçonte vendin përreth, gjë që e ndihmonte të shihte më mirë, por që mund ta tradhtonte kur të futej në ujë. Yjet tashmë ndriçonin.

Ishte një qetësi aq e thellë, saqë ai dëgjonte rrahjet e zemrës së tij. Rrahjet e saj u bënë më të shpeshta kur pa tri grupe ushtarësh të hynin në mes të grurit. U tremb dhe u struk më shumë mes shkurreve, pothuajse u bë njësh me to.

Dëgjonte hapat dhe zërat e tyre në rrugë, por nuk mori vesh asgjë. Shkurret e gërricën në krahët e dobët, por as që e ndiente dhembjen e tyre. Ushtarët ia prishën planin.

Kishte vendosur të hynte në ujë e të notonte derisa të kalonte në anën tjetër të kufirit, por në ato çaste e kishte të pamundur. Kishte frikë se ata mund ta pikasnin, ndaj ndryshoi mendim. “Tani nuk kam asnjë shans, por do të mundohem të kaloj më këmbë”, tha me vete. Dhe ashtu bëri. Priti derisa ushtarët u larguan duke humbur në detin e grunjte, u ngrit ngadalë e me kujdes dhe hodhi vështrimin rreth e rrotull. Nuk e kishte idenë e kohës, pasi nuk kishte orë, por duhej të ishte rreth njëmbëdhjetë e mbrëmjes. Eci për afro një kilometër dhe përpara i doli një brez i butë toke i punuar shumë imët, ku të mbeteshin gjurmët e këmbëve, nëse kaloje mbi të.

Zemra filloi t’i përpëlitej brenda kafazit të vogël. Vazhdimisht dëgjonte rrahjet e saj. Diçka brenda vetes i thoshte se do t’ia dilte mbanë.

Kaloi brezin e butë, gjithnjë duke vështruar me kujdes përreth dhe arriti te kloni. Një buzëqeshje e lehtë iu përvijua nga buzët e plota, të cilat i ishin tharë nga etja.

Sikur të kishte një shishe me ujë, do ta pinte të gjithën. Po ku ta gjente? Nuk i kishte shkuar ndër mend se do t'i duhej. Sytë i shkuan te kokat izoluese të telave që përcillnin rrymën elektrike. Filloi të vriste mendjen. Diçka duhej të bënte, po çfarë? Mendoi të gërmonte tokën nën të, por nuk kishte asnjë mjet. “Ah, sikur të kisha një lopatë të vogël, ose një thikë të madhe që të hapja vendin poshtë telave!”, tha me vete. Po të gërmonte me duar e thonj, do të humbiste kohë e ndoshta nuk do t'ia dilte, ndaj vazhdoi rrugën përgjatë klonit.

Ndali për një çast dhe mbajti frymën. Asgjë nuk pipëtinte. Dëgjonte vetëm të rrahurat e zemrës së tij, që vazhdonte të përpëlitej brenda krahavorit si një zog në kafaz. Vazhdoi të ecte, kur papritur, rreth shtatë-tetë metra më tutje, dalloi një hije. Mbajti frymën përsëri dhe vuri dorën sipër gojës. Merrte frymë vetëm me hundë.

Iu duk sikur zemra do t'i pushonte nga çasti në çast. Bëri dy-tre hapa përpara. Ishte ushtari i shërbimit. Ishte ulur dhe mbështetur pas një peme. Automatikun e kishte pranë vetes, në krahun e djathtë.

Kapelën e kishte hedhur mbi sy dhe streha e saj ia kishte mbuluar fytyrën. Flinte për shtatë palë qejfe. Edhe po të ishte zgjuar, nuk e dallonte dot. Iu shmang dhe u largua me hapa të lehtë si ketër.

Më vonë u fsheh pas ca kallamishteve dhe ngadalë hoqi rrobat e trupit. I futi në një qese, së cilës i lidhi grykën dhe pastaj e lidhi rreth trupit. Hyri në ujë e nisi të notonte me not “bretkosë”. Uji ishte i qetë, vaj. Lagu buzët për të shuar etjen që e kishte mbërthyer.

I mësuar me shijen e ujit të detit, uji i liqenit iu duk i çuditshëm.

Nuk e mori vesh atë lloj shijeje të papërcaktuar ndërmjet shijes së ujit dhe të baltës. Një gllënjë i kaloi poshtë dhe i ra si plumb në stomak, por nuk kishte kohë të mendonte për këtë. U kollit lehtë dy herë, por menjëherë e mbylli gojën nga frika se dikush mund ta dëgjonte. Vazhdoi të notonte.

Buzë liqenit ishte një projektor i madh lëvizës dhe shumë i fuqishëm, që shërbente për të kontrolluar zonën në gjirin e vogël, aty ku pika e kalimit të kufirit ishte shumë afër. Drita e projektorit rrëshqiste mbi sipërfaqen e ujit si një gjarpër mbi barin e gjelbër.

Projektorin e kishte në krah të djathtë dhe sa herë i afrohej drita e tij, fuste kokën në ujë, ngadalë, për të mos krijuar rrahë, duke mbajtur frymën për disa sekonda. Mundi t'i shmangej disa herë projektorit, i cili rrotullohej vazhdimisht sipas një intervali të caktuar.

Sa më tepër largohej nga bregu, aq më shumë po e ndiente të ftohtët. Një çast, duke menduar se kishte notuar shumë dhe ishte larguar nga bregu, e humbi toruan dhe vazhdoi të notonte pa iu ruajtur projektorit, që e ndiqte pas.

Mirëpo projektori u fiksua mbi trupin e tij. U mundua të ndryshonte drejtim, por u tmerrua kur dëgjoi një breshëri automatiku. U zhyt në ujë dhe qëndroi për disa sekonda. Nxori kokën, por drita e projektorit e goditi si rrufe. U tremb për një çast, por nuk e humbi toruan. E mblodhi veten dhe truri filloi t'i punonte me shpejtësi.

Duke menduar se ishte fare pranë pikës kufitare jugosllave, u dha krahëve me tërë forcën e tij për të arritur sa më shpejt. Ndërkohë që notonte i uturiu një zhurmë në veshë, sikur t'i kishin futur një shtizë. Ishte zhurma e motobarkës së ushtarëve shqiptarë, që po i afrohej gjithnjë e më shumë.

Pastaj dëgjoi të shtëna me armë. Menjëherë nga ana jugosllave u lëshuan në qiell raketa ndriçuese, që e ndriçuan krejt hapësirën mbi liqen si të ishte ditë. Kështu vepronin gjithmonë në raste të tilla, për të parë nëse ndonjë i arratisur nga Shqipëria ishte futur në territorin e tyre.

Ushtarët jugosllavë ishin të gatshëm dhe shumë të interesuar që të ndihmonin të arratisurin nga Shqipëria. Barka vazhdonte ta ndiqte. Të shtënat po ashtu. Frika se mund ta kapte ndonjë plumb iu shtua së tepërmi. Ku ta dinte ai se ushtarët gjuanin me fishekë gjurmëlënës?

Mendoi të dilte në breg dhe u dha krahëve me sa fuqi kishte. Tashmë e kishte humbur orientimin. Nuk e dinte nëse ishte ende në ujërat shqiptare apo kishte hyrë në ato jugosllave. Vazhdoi të notonte me sa mundej dhe shpejt e pa veten në breg. U fsheh mes kallamishteve të larta, por ndjeu ftohtë.

Po dridhej dhe u mbloodh kruspull si kërmilli kur futet në guaskën e tij për t'u mbrojtur. Ca nga frika e ca nga të ftohtët, dhëmbët i kërcitnin pa pushim, aq sa nuk ishte në gjendje të kontrollonte lëvizjen e nofullave. Të shtënat e ushtarëve shqiptarë vazhdonin të linin gjurmë në ujin e liqenit.

Projektori, si një shpend i madh i zi, vazhdonte të rrotullohej me shpejtësi dhe ai u struk më shumë mes kallamishteve. Nga frika e harroi të ftohtët. Dëgjoi këmbët e ushtarëve tek vraponin duke bërtitur: “Ku shkoi, qeni?! Ku shkoi, qeni?!”. Priti mes ankthit dhe të dridhurave derisa zhurmat u fashitën krejt. Mendoi se ushtarët ishin larguar dhe doli nga kallamishtet. Mbajti vesh se mos dëgjonte ndonjë zhurmë apo zë të ushtarëve.

Qetësi. Përpara kishte një rrip toke me bar dhe pas saj fillonte një pyll me drurë të lartë dhe shkurre. “Nëse arrij të futem në pyll, do të humbas gjurmët dhe mund të kaloj në tokën jugosllave”, tha me vete dhe shpejtoi hapat, por papritur u përball me një ushtar. U tremb shumë. Jo më pak edhe ushtari, i cili mund të ishte dy apo tre vjet më i madh se Gjergji.

Ushtari shtrëngoi automatikun e ia dha një klithme të fortë e të zgjatur: “Ndaaaal!” dhe qëlloi drejt tij me breshëri. Plumbat i kaluan fare pranë, rreth tre apo katër centimetra mbi kokë.

Gjergji u drodh. Ushtarin e kishte përballë. Sytë e tyre u ndeshën nën dritën e hënës, si në një ndeshje boksi, ku kundërshtarët sfidojnë njëri-tjetrin për të parë fortësinë apo dobësinë e tjetrit. Dalloi frikë në sytë e ushtarit, por nuk mund të bënte asnjë lëvizje. Ai ishte i armatosur. Nëse do të vraponte, plumbat e automatikut të tij do ta bënin shoshë.

Këtë radhë ai nuk mund të gabonte si herën e parë.

E kuptoi që aty mbaroi aventura e tij. Ngriti duart lart dhe qëndroi ashtu për disa sekonda.

Në çast iu kujtuan njerëzit e tij të dashur: nëna, babai, vëllai, kushërinjtë në Fier, me të cilët ishte ndarë para disa orësh. Pa e kuptuar as vetë, iu përvijua në mendje fytyra e Lindës, vajzës me të cilën sapo ishte njohur, me atë të qeshurën e saj të ëmbël, që sapo kishte filluar ta shijonte.

Çfarë do të mendonte ajo, kur ta merrte vesh se ai kishte tentuar të kalonte kufirin, të arratisej? Do ta urrente që po e braktiste, apo do të ndiente mëshirë dhe keqardhje për të?

Nuk pati kohë të mendonte më gjatë, sepse ia behën ushtarët e tjerë duke bërëtitur dhe iu hodhën sipër e nisën ta goditnin pa mëshirë.

- Ku do të shkoje, qen bir qeni, në Jugosllavi?! Deshe të arratiseshe, ëëë?! Nuk të pëlqen Shqipëria ty?! - i ulëriti njëri prej tyre, që, me sa dukej, ishte komandanti i skuadrës.

Gjergji nuk mund të lëvizte. As nuk mundi t'i përgjigjej pyetjes së tij. Klithmat e ushtarëve ishin të frikshme. Zemra i përpëlitej si një zog i vogël nën kthetrat e një shpendi grabitqar.

Pasi largoi njërin nga ushtarët që po e qëllonte, komandanti e goditi me shkelm në brinjë. Nga dhimbja, Gjergjit i shpëtoi një "ooooh!" e gjatë, sytë iu errën dhe nga goja nisi t'i rridhte gjak.

Kur dëgjoi pyetjen që i kishte bërë ushtari, Gjergjit iu kujtua vdekja e diktatorit, që kishte ndodhur një muaj më parë, në prill. Ndryshe nga shokët e tij të klasës, ai nuk kishte marrë pjesë në homazhet që kishte organizuar shkolla në nderim të udhëheqësit. Madje,

kur kishte vdekur ai, atij i ishte ngjallur shpresa se diçka do të ndryshonte në jetën e shqiptarëve.

Dy prej ushtarëve e kapën nga krahët dhe e ngritën në këmbë, të tjerët e rrethuan dhe e urdhëruan të ecte përpara. Duke e goditur herë pas here me qytat e automatikëve që mbanin në krahë, e shoqëruan deri në postën kufitare. Atje ushtarët i kapi një histori e tmerrshme. E goditnin pa pushim dhe pa mëshirë në çdo pjesë të trupit të tij të njomë.

Më pas, çuditërisht, nuk i ndiente goditjet e tyre. Madje as të ftohtin, edhe pse vazhdonte të ishte vetëm në të mbathura. Duart e njoma ia lidhën me tel të hollë dhe nga shtrëngimi kyçet i ishin mavijosur. Ushtarët nuk kishin pranga, sepse posta kufitare ishte repart ushtarak dhe nuk e përmbante rregullorja.

Alarmi ishte dhënë. Në repart kishte ecejake të vazhdueshme dhe britma të frikshme. Më pas mbërriti kryetari i Degës së Punëve të Brendshme të Pogradecit. Në atë çast ushtarët i ndaluan goditjet mbi trupin e tij dhe e lanë vetëm me kryetarin, i cili filloi ta pyeste rreth qëllimit të arratisjes dhe t'i bënte presion për ta frikësuar.

- Ku doje të shkoje? Doje të shkoje në Jugosllavi për të bërë homazhe te varri i Titos? - ishte pyetja e tij e parë.

Gjergji nuk u përgjigj. I habitur, i hodhi një vështrim gjithë frikë, pa kuptuar qëllimin e pyetjes. Vështrimi i tij dukej sikur thoshte: “Ç’punë kam unë me Titon?!”.

E mbajtën në hetuesinë e qytetit të Pogradecit për afro dy javë. Më pas e nisën në qytetin e Durrësit.

Udhëtimi deri në Durrës, i cili zgjati rreth katër orë, ishte i tmerrshëm. E hipën në një “Zuk” dhe gjatë gjithë rrugës e detyruan të rrinte shtrirë në dyshtemenë e makinës me duar të lidhura, këtë herë me pranga, dhe njëri nga policët ia mbante këmbën mbi gjoks për të mos e lejuar të lëvizte. Derisa mbërritën në Durrës, kurri iu bë copë nga tronditjet e makinës.

Pas disa muajsh tortures në hetuesi, Gjergjin e nxorën në gjyq. Aktakuza ishte “tradhti ndaj atdheut, e mbetur në tentativë”. Seanca u zhvillua me dyer të hapura dhe mund të merrnin pjesë të gjithë ata që dëshironin, por pjesa më e madhe e njerëzve ishin të ftuar nga organet shtetërore. Gjykata kishte ftuar të gjithë drejtorët e shkollave të qytetit, si dhe trupën pedagogjike të gjimnazit “Naim Frashëri”, nxënës i të cilit ishte Gjergji. Gjithashtu, e ftuar ishte edhe organizata e rinisë së shkollës.

Duke qenë se Gjergji ishte i mitur, trupi gjykues i caktoi një grua në rolin e avokates, por ajo nuk e mbrojti për asgjë, thjesht lexoi kërkesën e prokurorit, i cili i kërkoi trupit gjykues të ulte dënimin. Kryetar i trupit gjykues ishte shoku Braçe, i cili nuk e pranoi kërkesën.

- Gjarpërinjve duhet t’u shtypet koka sa janë të vegjël! - tha ashpër ai.

Gjergjin e dënuan me dhjetë vjet burg, por duke qenë se ishte i mitur, ia përgjysmuan, ia lanë dënimin pesë vjet. Në gjyq trupi gjykues bëri çmos që ta paraqiste Gjergjin me veset më të këqija që mund të ketë një djalë i asaj moshe, sepse ai duhej të bëhej shembull për të tjerët. Ai duhej të shpallej armik i

popullit, sepse kishte dashur të arratisëj, ta tradhtonte atdheun.

Në vendimin e gjykatës, ndër të tjera, thuhej se “me veprimin e tij armiqësor ai i kundërvihet rinisë sonë të pastër revolucionare, e cila është mobilizuar më tepër se kurrë ta kthejë dhimbjen në forcë, me moton *punë dhe vigjilencë*”.

Gjithashtu, trupi gjykues kërkoi të lexohej një relacion për sjelljen dhe qëndrimin e Gjergjit në shkollë, por u ngeci sharra në gozhdë, sepse relacionin e kishte bërë mësuesja e tij kujdestare, Aneta.

Ajo kishte shprehur një dashuri të madhe për nxënësin e saj, duke e cilësuar si djalë të zgjuar, të shkathët, por me një natyrë të heshtur. Relacioni ishte një goditje e fortë për trupin gjykues, pasi e nxori bluf, por nuk ndikoi aspak në uljen e dënimit të djaloshit guximtar dhe inteligjent.

Pasi mori dënimin, e deri në fund të muajit nëntor, Gjergjin e mbajtën në burgun e Tiranës. Më pas e transferuan në burgun e tmerrshëm të Qafës së Barit në Tuç të Pukës. Udhëtimi nga Tirana deri atje me makinën autoburg, që ishte si një kazan i madh lëvizës, pa mundësi ajrimi, ishte një torturë më vete për Gjergjin. Ishte një udhëtim sflitës, që zgjati tetë orë.

Brenda në autoburg ishin dhjetë të dënuar, të gjithë të lidhur me zinxhirë. Gjatë udhëtimit disa prej tyre nuk ndiheshin mirë dhe pothuajse gjithë rrugën mbetën duke vjellë. Nga të vjellat e tyre, ajo hapësirë e vogël brenda makinës u mbush me një erë të rëndë, të padurueshme.

Në burgun e Qafës së Barit Gjergji qëndroi deri në janar të vitit 1986. Për fatin e tij të mirë, ai përfitoi nga një amnisti që presidenti i vendit shpalli atë vit.

Jeta e tij do të ndryshonte shumë pas daljes nga burgu. Ai nuk duhej të lëvizte më i vetëm, lirshëm, siç bënte para se të hynte në burg. Për shtetin ai ishte një element i rrezikshëm dhe duhej ruajtur, sepse prej tij mund të prisje çdo gjë.

Sigurimi i Shtetit kishte menduar t'i caktonte nga pas një njeri, i cili do të kontrollonte të gjitha lëvizjet dhe veprimet e tij.

Shoqëruesi i Gjergjit ishte Larashi (ai kishte emër tjetër, por kështu njihej nga të gjithë), një djalë rreth tetë vjet më i madh dhe që ishte komshiu i tij; jetonin në të njëjtin pallat.

Gjergji as që e mendonte se Larashin do ta kishte “truprojë” në largësi. Larashi e kryente me zell të madh detyrën që i kishin ngarkuar. Ai ishte djali i një marinari komunist të eksportit, që dilte jashtë Shqipërisë.

Sigurisht, një pjesë e konsiderueshme e marinarëve dhe shoferëve të eksportit shqiptar, ishin bashkëpunëtorë të Sigurimit të Shtetit dhe i shërbenin atij me devotshmëri të pashembullt, deri në vetëmohim.

Pas daljes nga burgu Gjergji u bë edhe më i heshtur. Tashmë nuk shoqërohej me askënd. Ata pak muaj burg i kishin shërbyer për të nxjerrë mësimet e duhura. Shkollën e la, nuk shkonte më.

E vetmja me të cilën shoqërohej ishte Linda, vajza që ai dashuronte. Me të ishte lidhur që para se të

hynte në burg. Ishin moshatarë dhe ajo e dashuronte marrëzisht, por edhe me të mendohej të mos binte në sy. Xhelozia e djemve të tjerë mund t'i hapte probleme.

Linda ishte një vajzë shumë e bukur. Ishte trup-gjatë, ashtu si Gjergji. Kishte flokë shumë të gjatë ngjyrëgështenjë, me pak onde që i dallgëzoheshin mbi supet e plota kur ecte, e gjithë djemtë kthenin kokën për ta parë.

Fytyrën e kishte shumë të pastër, ballin të lartë e të gjerë, vetulla të trasha, sy të mëdhenj ngjyrëkafë, hundë të bukur e shumë të rregullt, buzë të plota dhe epshndjellëse, që do t'i dëshironte çdo burrë.

Mjekra vinte e butë dhe mjaft e rregullt, në harmoni me fytyrën e saj engjëllore. Linda kishte një vështirësi të mprehtë. Ishte vajzë e zgjuar, e dhembshur dhe guximtare.

Për Gjergjin Sigurimi i Shtetit kishte planifikuar një strategji të veçantë. Pasi të mbushte moshën tetëmbëdhjetëvjeçare, ai do të merrte dënim të plotë dhe jo të përgjysmuar si herën e parë.

Në planin që po organizonte, Sigurimi i Shtetit përfshiu edhe Lindën. Punonjës të Sigurimit e kishin thirrur atë në Degën e Punëve të Brendshme dhe i kishin bërë presion.

Ajo duhej të informonte Sigurimin rreth veprimtarisë që Gjergji po përgatiste kundër pushtetit popullor. Linda ishte tronditur nga planet e errëta të Sigurimit kundrejt të dashurit të saj. Në pamundësi për t'u takuar lirisht si më parë dhe për të mos rënë në sy të të tjerëve, ajo shkroi një letër dhe ia dërgoi në

fshehtësinë më të madhe me anë të një djali të vogël.
Në letër ajo i shkruante:

*I dashur dhe i shtrenjti im Gjergj,
tani që po të shkruaj këtë letër jam e mërzitur dhe
e tronditur shpirtërisht. Të kam dashur gjithmonë e të
kam respektuar, se i di vuajtjet e jetës sate, prandaj
nuk dua që të biesh prapë në atë llum dhe të shkosh
në atë derë të ndyrë.*

*Unë do të t'i them shumë qartë fjalët, me qëllim
që edhe ti të më besosh se e kam seriozisht, se të dua
gjithmonë të mirën dhe me këtë që unë po të tregoj, të
vij ty në ndihmë. Më beso, të lutem!*

*Një shok që ti ke pasur para disa kohësh të ka
përgatitur një kurth. Qëllimi dihet: duan të të rrasin
prapë në burg, por ti mos i prano ato që ke thënë dhe,
në qoftë se ke në plan të bësh ndonjë gjë, mos e bëj, se
do të të kushtojë gjithë jetën. Ty po të ndjekin kudo që
shkon, në çdo veprim që bën, ndaj bëj kujdes.*

*Unë nuk do t'i harroj kurrë ato ditë të bukura
plot gëzim, ato orë që kaluan shumë shpejt dhe nuk u
çmallëm dot, ashtu siç çmallen dy të dashuruar. Ti ke
nevojë për një fjalë të mirë dhe për ngrohtësi, siç e ke
thënë edhe vetë.*

*Ne vërtet jemi larg njëri-tjetrit, vërtet nuk shihemi,
por dashuria dhe respekti nuk janë zhdukur. Ato
ekzistojnë në zemrën time. Në zemrën dhe në shpirtin
tënd, nuk e di nëse ekzistojnë ende dhe për këtë nuk
di ç'të them.*

*Të lutem, mos m'i merr me kuptim të keq këto që
po të shkruaj, por them atë që ndiej. Për këtë të keqe*

që të kanë bërë kam shumë për të shkruar, por nuk t'i shkruaj dot të gjitha, sepse kam shumë frikë se mos kjo letër bie në duart e dikujt tjetër.

Uroj të kesh fat! Zoti të ndihmoftë!

Të përqafoj me shumë mall!

Shoqja jote L. Z.

Në krah të djathtë të letrës, vertikal, Linda i kishte shkruar: *Lexoje dhe grise! Mos harro!*

Letra e saj e tronditi Gjergjin. I erdhi shumë keq për Lindën, e cila në mënyrë krejt të rastësishme dhe aksidentale ishte përfshirë në këtë aventurë të rrezikshme. Në mesin e letrës Gjergji pa të vizatuar me laps gishtërinjtë e dorës së saj. Ata gishta e futën në mendime.

Ajo dorë e vënë mbi atë letër ishte betimi i Lindës për të. Ajo i premtonte besnikëri të përjetshme. Të paktën ai kështu e kuptonte.

Nuk e grisi letrën, por e ruajti si një relikte të çmuar. Një frikë e brendshme i thoshte se mund ta humbte njëherë e përgjithmonë, ndaj të paktën të kishte diçka të sajën si kujtim. Do ta ruante në kasafortën e zemrës së tij dhe çelësin e saj do ta hidhte diku për të mos e gjetur më kurrë.

Në mesin e muajit maj Gjergji mbushi tetëmbëdhjetë vjeç. Për Sigurimin e Shtetit tashmë ai ishte “i madh” dhe i vetëdijshëm për veprimet që kryente. Larashi nuk i ndahej. E ndiqte hap pas hapi si zagari gjahun e tij. Nuk kaloi shumë dhe një ditë të bukur të muajit korrik 1987 u arrestua përsëri. Dhe ja se si ndodhi:

Atë mëngjes Gjergji doli nga shtëpia si zakonisht. Në oborrin e pallatit u ndesh me Larashin, i cili e pyeti se ku do të shkonte.

- Në plazh do të shkoj, - iu përgjigj ftohtë.

Larashi iu vu pas. Kur zbriti nga autobusi i plazhit në sektorin “Hekurudha”, vuri re se Larashi kaloi pranë tij me biçikletën që ia kishte sjellë i ati nga jashtë. U përshëndetën përsëri dhe në çast Gjergjit iu kujtua pasditja e djeshme, kur bashkë me babanë e tij ndodheshin në lokalin pranë shtëpisë së tyre. Ata qëndronin më këmbë përballë tavolinave të larta dhe po pinin nga një kafe.

Ndërkohë, Larashi bënte ecejake me biçikletë përgjatë rrugës nga spitali deri te Dega e Punëve të Brendshme dhe anasjelltas. Nuk i kishte shkuar kurrë ndër mend qëllimi i lëvizjeve të tij. Ndërsa ecte i qetë në rrugën që të çonte në breg të detit, ndjeu nga pas katër duar të fuqishme dhe njëri prej agresorëve i tha:

- Gjergj Koni, në emër të popullit je i arrestuar!

Këtë radhë e dënuan njëmbëdhjetë vjet. Aktakuza që e njëjta si herën e parë, por me ndryshimin se këtë herë nuk e kishin kapur në flagrancë në vijën e kufirit dhe i kishin shtuar fjalën “përgatitje”. Aktakuza e plotë në sallën e gjyqit ishte: “Përgatitje për arratisje dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor”.

E degdisën përsëri në kampin e tmerrshëm të Qafës së Barit, dënim që e kreu deri në muajin mars të vitit 1991, kur me përmbyshjen e sistemit komunist të burgosurit politikë fituan lirinë.

Gjergji mundi të përfitonte shtatë vjet liri me përmbyshjen e sistemit, por në ndërjegje, vuajtjet

dhe mizoritë që kishin hequr ai dhe shokët e tij bashkëvuajtës, do të linin gjurmë të thella.

* * *

Ëndrra e vuri në mendime të thella. Mbaroi kafënë dhe më pas u ngrit. Filloi të vinte vërdallë nëpër kuzhinë me cigaren në dorë, të cilën nuk e kishte mbaruar ende. Tymi ngjitej lart ngadalë si një re e vogël në qiell të kthjellët. E shoqëroi me sy.

Ndërkohë, mori gotën e rakisë dhe e rrëkëlleu me fund. Mbylli për një çast sytë dhe ndjeu gjoksin t'i nxehej sikur dikush t'i kishte vënë një copë thëngjilli mbi të. Mori shishen mbi tavolinë dhe e mbushi gotën përsëri.

Rakia i pëlqente shumë dhe ishte nga ata burra që e mbante. Kur pinte, sikur e harronte të kaluarën dhe vinte në qejf. Kjo zgjaste pak, se më pas kthehej me këmbë në tokë dhe e kaluara e errët i kalonte para syve si një tufan i acartë në dimrin e jetës së tij.

Ashtu i ndodhi edhe atë çast. Iu kujtua mendimi që i kishte lindur para ca kohësh, ndaj dhe ëndrrën e sapoparë e lidhi me të. Humnera mund të paraqiste në ëndërr një ankth të madh, një gjendje të vështirë psikologjike, si dhe një stres të grumbulluar me kohë, të cilin nuk po mundte ta shkarkonte e të çlirohej njëherë e mirë nga frika dhe tmerrri, gjë që po ndikonte negativisht në jetën e tij. Po ndjekja e policisë me qen, çfarë mund të ishte? Si mund ta shpjegonte? Mos vallë kishte të bënte me drejtësinë, me ligjet e shtetit për të mos gabuar dhe të ishte më i vetëpërmbajtur?

Tekefundit, edhe në jetën e përditshme figura e policit mund të shihet me sy të mirë, pra si një njeri që mbron rendin dhe sigurinë, por mund të shihet edhe si dikush që na shkakton ankth, frikë dhe tmerr.

Gjergji me këtë sy i kishte parë gjithmonë policët, sepse të tilla kishin qenë marrëdhëniet e tij me ta.

Ky mendim i vinte sapo kthente një gotë. E mundonte vazhdimisht. Ishte një mendim i guximshëm, por edhe i frikshëm, aq sa, kur e kujtonte, i rrëqethej trupi. Nuk ia kishte thënë asnjërit. Nuk guxonte.

Duhej ta mendonte dhe ta planifikonte në mënyrë të përkryer, për ta vënë në zbatim atë plan. Dikush do ta quante të çmendur, po ta dinte. I vetëm do ta kishte të vështirë, gati të pamundur.

Dot' i duhej patjetër ndihma e shokëve të dikurshëm. Po ku t' i gjente? Një pjesë e bashkëvuajtësve të tij kishin vdekur, një pjesë ishin larguar nga Shqipëria. Kishin marrë arratinë sapo vendi hapi kufijtë me vendet e tjera. Ishin larguar për të mos kujtuar asgjë nga e kaluara e hidhur e regjimit komunist, që u kishte marrë pjesën më të bukur të jetës. Ishin larguar në vendet perëndimore për të shijuar pjesën e mbetur të jetës, në Perëndimin që ata kishin ëndërruar në rini, por që nuk kishin mundur ta preknin.

Mbaroi cigaren dhe e shoi në tavllën e qelqit që ndodhej mbi tavolinë. Ktheu përsëri një gllënjë raki. Iu kujtua Genci, shoku i tij i vuajtjeve, shoku i idealit, me të cilin kishte kaluar vite të vështira në burgun e Qafës së Barit. Shkoi në dhomë dhe mori celularin. Kërkoi numrin e tij, shtypi butonin e thirrjes dhe e

ngjeshi celularin në veshin e djathtë. Pas tringëllimës së tretë dëgjoji zërin e Gencit:

- Alo!

- Alo, Genc, mirëmëngjesi! Jam Gjergji.

- Mirëmëngjesi, Gjergj! Po, po, e kam emrin tënd të regjistruar.

- Si ke qenë? Me shëndet mirë je? Gruaja, fëmijët, mirë janë? - pyeti Gjergji.

- Po hajt mo, Gjergj, mirë të themi! - u përgjigj Genci duke psherëtirë.

- Je i lirë tani? Desha të pi një kafe me ty.

- Posi ore! E diel është sot, dalim dhe e pimë. Po ku?

- Po vij të të marr me makinë dhe shkojmë diku nga lokalet e plazhit.

- Mirë, po të pres. Mos u vono!

- Për dhjetë minuta jam aty. Zbrit poshtë, që të mos vonohemi.

- Më gjen poshtë, Gjergj! Pa problem. Hajde, nxito!

2.

Genc Tabaku u lirua nga burgu në fillim të vitit 1989. Ishte disa vjet më i madh se Gjergj Koni. Vinte i mbushur dhe me trup mesatar, me fytyrë rrumbullake të ashpër, flokë të dendur, të thinjur, sy të gjallë në ngjyrë kafe. Mbante mustaqe, të cilat, në ndryshim nga flokët, ende nuk i ishin thinjur. Kishte duar të mëdha e gishta të gjatë me thonj të ngrënë në formë katrore. Ishte i martuar dhe kishte dy djem.

Ai ishte dënuar në vitin 1978 me nëntë vjet heqje lirie për dëmtim të portretit të Enver Hoxhës, por, në të vërtetë, bëri njëmbëdhjetë vjet.

Në kohën kur kryente shërbimin ushtarak, në repartin e tij kishte ndodhur një ngjarje e pazakontë dhe shumë e rëndë për kohën: ishte dëmtuar ose, më saktë, ishte thyer portreti i udhëheqësit.

I gjithë reparti u vu në alarm. U morën në pyetje të gjithë ushtarët dhe mbi ta u ushtrua dhunë fizike e psikologjike. Dikush duhej të dënohej. Dikush duhej të bëhej kokë turku. Fajtori duhej gjetur patjetër.

Ky ishte urdhri nga komanda dhe duhej zbatuar me çdo kusht. Njërin nga ushtarët e dhunuan aq shumë,

saqë e humbi fare toruan dhe nuk dinte se ç'fliste. Ndër të tjera, ai tregoi se portretin e kishte thyer Genc Tabaku. Menjëherë kishin thirrur në hetuesi Gencin. Atij i kërkuan të pranonte fajin e rëndë dhe të thoshte se këtë veprim e kishte bërë me urdhër të komandantit. Genci nuk kishte pranuar. Nuk kishte si ta pranonte një veprim që nuk e kishte kryer.

Gjatë marrjes në pyetje ai u tha hetuesve se në kohën kur ishte dëmtuar portreti i udhëheqësit, nuk ndodhej në repart, mbasi kishte qenë me leje, i ftuar në një dasmë. Kur ishte kthyer, e kishin vënë në dijeni për atë që kishte ndodhur, gjë që kishte vënë në alarm gjithë repartin. “Shyqyr që kam qenë me leje dhe jam jashtë kësaj loje...”, kishte thënë me vete Genci dhe ishte ndier i qetë.

Duke u gjendur para një fakti të tillë, hetuesia urdhëroi njërin nga oficerët e repartit që të zhdukte regjistrin e liridaljeve, ku figuronte edhe emri i ushtar Genc Tabakut. Në këtë mënyrë hetuesit humbnin çdo gjurmë.

Duke ia mohuar lejen që kishte marrë, dënimi i tij bëhej më i lehtë e më i besueshëm. Ai kishte kundërshtuar me forcë, por vendimi u mor në zyrat e Sigurimit të Shtetit. Genc Tabaku duhej të dënohej me çdo kusht, po ashtu dhe komandanti i tij.

E mbajtën në hetuesi për më shumë se katër muaj. Hoqi të zitë e ullirit. Në birucë policët lagnin dyshtemenë me ujë, me qëllim që ai të mos shtrihej. As batanije për t'u mbuluar nuk i kishin dhënë. Veç torturave fizike, të cilat kishte mundur t'i përballonte

falë moshës së re dhe fizikut të tij të mirë, hetuesi e torturonte edhe psikologjikisht. Brenda në birucë i futën edhe një të dënuar tjetër, i cili e provokonte vazhdimisht. Falë inteligjencës së tij, Genci ia doli ta shmangte spiunin, i cili nuk kish mundur të blinte asgjë prej tij.

Në fund Genci pati edhe një ballafaqim me komandantin e repartit. As njëri dhe as tjetri nuk e kishin pranuar fajin e shpikur nga Sigurimi i Shtetit. Komandanti i repartit ishte vënë në shënjestër me kohë, e më në fund u gjet pretexti për këtë veprim, të cilin nuk dihej se kush e kishte bërë. Atë e dënuan me dhjetë vjet heqje lirie, ndërsa Gencin me nëntë vjet.

Në fillim Gencin e dërguan të vuante dënimin në burgun e Ballshit, më pas në burgun e Lezhës e në fund në burgun e Qafës së Barit. Gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e tmerrshëm, e dënuan për së dyti me akuzën për agjitacion e propagandë brenda mureve të burgut.

Në gjyq, gjyqtari e pyeti nëse e pranonte akuzën. “Po, e pranoj! Këtë herë e pranoj i bindur, sepse e kam sharë Partinë dhe Enver Hoxhën. Nuk ju kam dashur, nuk ju dua dhe nuk do t’ju dua asnjëherë!”, iu përgjigj Genci. Me këtë akuzë e kishin ridënuar me dhjetë vjet heqje lirie.

Me të dalë nga burgu, i ishte sulur kufirit grek dhe përfundoi në qytetin e Selanikut. Pjesën më të madhe të rrugës nga Kapshtica deri në Selanik e pati bërë më këmbë, duke udhëtuar maleve dhe pyjeve. Kishte qenë bashkë me dy shokë të tjerë, po nga Durrësi.

Punoi për afro tre vjet atje, në punë nga më të ndryshmet, më pas u kthye në Shqipëri me një grusht dhrahmi. Hapi një bar dhe vazhdoi të merrej me të.

Dy vjet më pas u martua me shkuesi dhe në harkun e tre-katër vjetëve u bë baba i dy djemve. Me kalimin e viteve e zgjeroi aktivitetin dhe, së fundi, po mendonte ta shndërronte në restorant.

E shoqja e ndihmonte në punët e lokalit e njëkohësisht merrej me mbarëvajtjen e familjes. Genci ishte mënjanuar nga shoqëria dhe shikonte vetëm punën e tij. Përvoja e hidhur e jetës i kishte dhënë mësim të vjera.

Mbante lidhje vetëm me dy-tre nga shokët e viteve të burgut, të cilët herë pas here vinin në lokalin e tij dhe rrëkëllenin ndonjë gotë. Njëri prej tyre ishte edhe Gjergji, për të cilin kishte respekt të veçantë, qysh në kohën kur vuanin dënimin në burg. Kishin qenë bashkë për pesë vjet.

Gjergji mori makinën, një “Volksvagen-Golf” i viteve nëntëdhjetë, që e kishte blerë në tregun e makinave në kohën kur kishte marrë shpërblimin qesharak për vitet e burgut, dhe pas afro pesëmbëdhjetë minutash u gjend poshtë shtëpisë së Gencit, i cili banonte në një nga hyrjet e “Pallatit të çekëve”.

Kështu njihej ai pallat. E kishte marrë këtë emër që nga koha kur Shqipëria kishte marrëdhënie miqësore me vendet e Lindjes dhe të Europës Qendrore. Në atë pallat kishin banuar specialistë me kombësi çeke.

Ndërsa një pjesë tjetër e durrsakëve, sigurisht, më të rinj, e njihnin ndryshe, e quanin “Pallati i dyqanit